# DËSHMI ARKIVI

**A-443026**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pasuritë e sekuestruara/ Deputeti Gjoni: Shkojnë sërish në duart e pronarëve. Kreu i AAPK: Nuk ka përfitues të tillë, përdoren për nevoja të shtresave vulnerabël |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/pasurite-e-sekuestruara-deputeti-gjoni-shkojne-serish-ne-duart-e-pron-i514066` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 12:21:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 11:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `535c1685f3f8ca93bd5f534e328cb4769d46eae821a0e4a368d1dbe4febe476a` |
| TEKSTI | `27047dcf2f8672876ec994ea9463761ca9c8f507217cbc2ce4874d8b6ba17a58` |
| PAMJA | `667c88e1e4d57cf05ca6957bcb693711e8a4703dc77637d33f800462fd39fcd0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c652f5c28bd12185d0739fe07c571dd892d086660541091ff7a2b1219f4f791e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0b6439cf09af002acf6ffba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c652f5c28bd12185d0739fe07c571dd892d086660541091ff7a2b1219f4f791e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

3 ORE ME PARE
Protestë te Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

3 ORE ME PARE
Nis viti i ri shkollor në sistemin parauniversitar / Rënie e numri të nxënësve, trafik i rënduar dhe alarm i rremë për bombë

19 ORE ME PARE
Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

20 ORE ME PARE
Reforma e re territoriale/ Rama përplaset me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

Aktualitet

# Pasuritë e sekuestruara/ Deputeti Gjoni: Shkojnë sërish në duart e pronarëve. Kreu i AAPK: Nuk ka përfitues të tillë, përdoren për nevoja të shtresave vulnerabël

Më tej, ajo sqaroi se apartamentet e sekuestruara, përdoren vetëm për nevoja të shtresave vulnerabël dhe të policëve të rënë në krye të detyrës.

dosja
14 Shtator 2026, 13:50
Nga E.d



Pamje nga takimi

**TIRANA-** Ditën e stome në Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale është zhvilluar një diskutim mbi administrimin dhe përdorimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, i u drejtua nga Fatmir Xhafaj. Deputeti i Partisë Demokratike, Gjin Gjoni u shpreh se ka informacione se një pjesë e madhe e pasurive të sekuestruara shkojnë në duart e atyre që u janë sekuestruar, nëpërmjet mënyrave të ndryshme, me një çmim modest.

Në lidhje me këtë, kryeadministratorja e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Konfiskuara, Risena Xhaja tha se deri më sot nuk i ka rezultuar të ketë përfitues të tillë. Kjo ndërsa sqaroi procedurat e dhënies me qira dhe përdorimit të këtyre pronave. Më tej, ajo sqaroi se apartamentet e sekuestruara, përdoren vetëm për nevoja të shtresave vulnerabël dhe të policëve të rënë në krye të detyrës.

Deputeti Gjin Gjoni i drejtoj edhe disa pyetje të cilat lidheshin se sa pasuri shkojnë në favor të viktimave dhe se sa pasuri përdoren për efekt parandalues. Në lidhje me këtë, Xhaja u përgjigj duke thënë se aktualisht pasuri në administrim janë njësi dhe apartamente, por edhe kullota. Sipas saj, nuk ka hapësira për t'ia vënë në dispozicion gjykatave.

**Pjesë nga diskutimi**

***Gjoni:*** *Kam informacione se një pjesë e madhe e pasurive të sekuestruara shkojnë në duart e atyre që u janë sekuestruar, nëpërmjet mënyrave të ndryshme, me një çmim modest. Keni informacione në lidhje me këtë dhe a duhet të bëhen rregullime ligjore për këtë çështje? Ka pasuri të sekuestruara që janë vënë në dispozicion të shtresave sociale në qarkun e Lezhës?*

## editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

## Në vëmendje

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 10:49
SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektivi i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:31
Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatrinë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

***Xhaja:*** *Për përfituesit është e vërtetë që kam dëgjuar se kalojnë përmes të tretëve në mbajtësit e parë të pasurive. Ka qenë shumë i mbyllur informacioni për pasuritë e konfiskuara dhe të sekuestruara. Deri më sot mua nuk më ka rezultuar të ketë përfitues të tillë. Kur qiramarrësi plotëson deklaratën, është përgjegjësi e tij më pas dhe e organeve hetimore. Kjo është procedura jonë, qiraja është 1-vjeçare.*

***Gjoni:*** *Unë di rast konkret që personi që ka pasur pronën, e ka marrë me qira dhe nuk ka sesi ai të denoncojë…*

***Xhaja:*** *Ne sigurohemi që ish-pronari nuk e ka marrë pasurinë në përdorim, kaq mund të bëjë ligji. Deri më tani na ka rezultuar që personat që i kanë marrë me qira nuk janë të njëjtët. Sa i përket gjykatave, vetëm Gjykata e Shkallës së Parë ka kërkuar zyra arkivore, po e shohim. Financime ka pasur GJKKO është rikonstruktuar me këto fonde. Kanë përfituar edhe Gjykata e Shkallës së Parë dhe Prokuroria e Tiranës. Në Lezhë nuk ka pasur kërkesa nga agjencitë për të përdorur ambientet e sekuestruara.*

***Gjoni:*** *Apartamentet e sekuestruara, a mund të shkojnë në dispozicion të shtresave në nevojë?*

***Xhaja:*** *Përdoren vetëm për nevoja të shtresave vulnerabël dhe të policëve të rënë në krye të detyrës.*

***Xhafaj:*** *Ju jeni administrues, nuk është merita juaj që objektet apo paratë janë sekuestruar. Detyra jua është administrimi, që ato pasuri të mos humbin vlerën. Pyetja është sesa mund të ndihmojë policia? Tjetra është sa pasuri shkojnë në favor të viktimave? Sa pasuri përdoren për efekt parandalues? Rezulton një kosto e lartë e administrimit nga ana juaj gjithashtu. Dhe sa objekte janë të përshtatshme që mund të vihen në dispozicion të institucioneve gjyqësore? Kemi disa gjykata me mungesë kapacitetesh. Po troje mund të ketë në lidhje me ndërtimin e mundshëm të këtyre institucioneve?*

***Xhaja:*** *Aktualisht pasuri në administrim janë njësi dhe apartamente, por edhe kullota. Nuk kemi hapësira për t'ia vënë në dispozicion gjykatave. Institucione që kemi akomoduar kanë qenë vila dhe njësi. Bëjmë thirrje edhe për trojet kush ka nevojë nga institucionet. Sa i përket kostove të administrimit, jam e kënaqur se janë ulur, pavarësisht se është rritur numri i punonjësve. Ka ndikuar pjesa e rojeve, pasi duke i dhënë me qira është ulur numri i tyre. Gjithashtu kemi vënë depozita në lek dhe ne marrim përqindje shumë të madhe të interesit për to. Nuk kam shifër sesa pasuri janë dhënë në përdorim, por pjesa më e madhe shkon në komunitet. Institucionet kërkojnë troje për logjistikë më së shumti. Ne duam të bëjmë një mënyrë të ndryshme sesi duhet t'i shesim pasuritë e paluajtshme. Kemi 3 vite që nuk shesim pasuri, po presim vendimin e Gjykatës së Lartë për ta definuar këtë proces.*/**Dosja.al**

aapk | gjin gjoni | pasuritë e sekuestruara

## Sondazh

Poll

Aktualitet

14 Shtator 2026, 13:41

# Aksident rrugor në aksin Fier–Mallakastër, plagosen tre persona

BOTA 14 SHTATOR 2026, 07:21

Analiza e The Economist: Pse Rusia po e dobëson qëllimisht monedhën e saj?

## më të klikuarat

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatrinë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

Takimet për Reformën Territoriale/ Rama në Berat: Çfarë lidhje ka distanca? Ndryshon vetëm drejtimi vendor

Tension te Zogu i Zi/ Protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre (VIDEO)

"Dil jashtë"/ Egla Ceno rrëfen përplasjen me kryeministrin Rama në Berat: Nuk pati provokime nga ana jonë, unë vetëm i kërkova të na dëgjonte (VIDEO)

## insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

## Moti

Powered by tomorrow.io

Foto ilustruse FIER- Një aksident rrugor ka ndodhur në aksin rrugor dytësor që lidh Fierin me Mallakastrën, në vendin e quajt...

### Viti i ri shkollor 2026-2027/ Mbyllet shkolla në Eçmenik të Devollit, kishte vetem dy nxënës

Aktualitet

14 Shtator 2026, 13:10

### VIDEO/ Kapen 41 kg e 350 gramë kokainë në Portin e Durrësit nga Brazili. Vlera në treg 2 milionë euro

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:59

### Aksident i rëndë rrugor në Peqin/ Audi përplas të moshuarin, 70-vjeçari ndërron jetë rrugës për në spital

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:03

### Theu urdhrin e mbrojtjes dhe plagosi me drapër ish-vjehrrin, arrestohet daja i Zegjine Çaushit në Roskovec

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:08

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:00

## Luxair sjell Luksemburgun përmes linjës së re me Tirana International Airport

Luxair 29 Mars 2027 do të shënojë nisjen e fluturimeve dy herë në javë midis Tiranës dhe Luksemburgut, përkatë...

### "Do të ishte e pafalshme të shkonim sërish në zgjedhje "/ Kurti bën thirrje për bashkëpunimin në zgjedhjen e

**presidentit të ri: Duhet të ecim përpara**

Aktualitet

14 Shtator 2026, 11:36

**Protesta te Zogu i Zi/ Policia: Procedohen penalisht 20 pjesëmarrës, bllokuan lëvizjen në akset kryesore të kryeqytetit**

Aktualitet

14 Shtator 2026, 11:28

**SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektivi i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark**

Aktualitet

14 Shtator 2026, 10:49

**VIDEO/ Tensione dhe përplasje fizike/ Protesta te Zogu i Zi, shoqërohen 10 aktivistë**

Aktualitet

14 Shtator 2026, 10:50

**MË SHUMË**





Berisha:Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës


Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin tonë për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Edi Rama


Berisha: Denoncuam farsën elektorale, sekretari Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet!


Berisha: Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti! Rama, vëllai i tij dhe qeveritarët janë...

## Berisha:Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës

Shiko video te tjera



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të



Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:


interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk

BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS
EDITORIAL

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.